



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 4183

NR. VENDIMI 7813

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.4183 Akti
7813 Vendimi
Date regj. 06.12.2017

Nr.

Date 01.10.2018

V E N D I M

" NË EMËR TË REPUBLIKËS "

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë, e përberë prej:
GJYQTARE : ENEIDA CIVICI

Asistuar nga sekretare e seancës Anjeza Nergjoni sot në dt. 01.10.2018 mori në shqyrtim në seancën gjyqësore publike çështjen civile me nr. 4183 akti me palë:

PADITËS: SHOQËRIA ***, me adresë ***, përfaqësuar në gjykim në bazë të autorizimit date ***nga Av. ***, me adresë njoftimi ***. (E papranishme në shpallje)

E PADITUR: SHOQËRIA ***, me adersë ***, përfaqësuar në gjykim në bazë të Prokurës ***, nga Av. ***.

PERSON I TRETË: DREJTORA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE.(Në mungesë)

OBJEKTI I PADISË: Shfuqizimin e markës tregëtare "****" me nr. kërkesë ***dhe nr. Regjistrimi ***, në pronësi të "****" sh.p.k, si regjistrim i cili shkel të drejtat e emërtimit tregëtar të markës ***.

2.Shfuqizimin e markës tregëtare "****" me nr. kërkesë *** dhe nr. Regjistrimi ***, në pronësi të "****" sh.p.k, si regjistrim i cili shkel të drejtat e emërtimit tregëtar të markës ***.

3.Ndalimin e përdorimit të markës *** në qarkullim tregëtar pasi sjell konkurrencë të pandershme.

4.Pushimin e cënimit të markës *** në qarkullim tregëtar.

5.Kryerjen e veprimeve për shfuqizim në regjistrin e markave pranë DPPI-së të dy markave objekt gjykimi.

6.Publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit qe ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.

7. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

OBJEKTI I KUNDËRPADISË: 1.Shfuqizimin e markës tregëtare "****", me nr. regjistrimi *** datë *** e mbrojtur për klasat 29, 30, 39.

2.Shfuqizimin e markës tregëtare "****", me nr. regjistrimi *** datë *** e mbrojtur për klasat 29, 30, 39.

3.Ndalimin e përdorimit të këtyre markave (objekt i kundërpadisë) në qarkullimin tregëtar.

4.Fshirjen në regjistrin e markave tregëtare pranë DPPI të këtyre dy markave objekt i kundërpadisë.

5.Publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në mediat publike me shpenzimet e palës paditëse/e kundërpaditur.

6.Shpenzimet gjyqësore palës paditëse/e kundërpaditur.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, (I ndryshuar), Kodi Civil, neni 638, 639, Kodi I Proçedurës Civile, neni 160, neni 348.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, pasi dëgjoi palët të cilat kërkuan:

Paditësi i kundërpaditur kërkoi: Pranimin e padisë, rrëzimin e kundërpadisë.

I padituri kundërpaditës kërkoi: Rrëzimin e padisë, pranimin e kundërpadisë.

Gjykata pasi shqyrtoi provat shkresore dhe analizoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Se paditësi i kundërpaditur i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë padinë me objektin e sipërcituar padi e cila bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën tokësore të kësaj gjykate.

Rrethanat e faktit:

Paditësi i kundërpaditur, shoqëria “****” sh.p.k me administrator dhe ortak te vetëm z. ***, është një shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjit shqiptar dhe regjistruar në Q.K.B me NUIS *** sipas Vendimit Nr. *** të datës *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo shoqëri prej datës së themelimit ushtron aktivitet tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj “Import-eksport te mallrave ushqimore, artkuj te ndryshem, ndertime e te tjera, blerje dhe tregtim Hidrokarburesh.Tregtimin e tyre me shumice dhe pakice brenda dhe jashte vendit.”

Në vitin 2014, paditësi i kundërpaditur shoqëria “****” sh.p.k, nëpërmjet kërkesës ***, ka aplikuar pranë DPPI-së ish DPPM-ja për regjistrimin e emrit të saj tregtar si markë tregtare me kërkesën datë *** dhe në datë *** është pajisur me çertifikatën e regjistrimit për markën “****” me nr. regjistrimi ***, e mbrojtur për klasat: 29 - Vajra për gatim, perime kryesisht fasule; 30 - Oriz, Sheqer; 39 - Ambalazhim dhe paketim mallrash ushqimore;

Në vitin 2016, paditësi i kundërpaditur, nëpërmjet kërkesës ***, ka aplikuar pranë DPPM

për regjistrimin e emrit të saj tregtar si markë tregtare dhe në datë *** është pajisur me çertifikatën e regjistrimit për markën “****” me nr. regjistrimi ***, e mbrojtur për klasat: 29 - Mish; ekstrakte mishi; xhelatinë mishi; yndyrna të ngrënshme; vaj ulliri për ushqim; vaj luledielli për ushqim.; 30 - Çaj; oriz; tul orizi për gatim; sheqer; kripë për gatim; erëza; miell gruri; miell misri; përgatitje nga drithrat; vanilje; erëza; 39 - Ambalazhim dhe paketim mallrash ushqimore;

I padituri kundërpaditës, shoqëria “**** Tiranë, me administrator dhe ortak ***, ***, ***, *** është një shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjit shqiptar, e cila ka fituar personalitetin juridik, me regjistrimin e saj ne datën ***. Si objekt i veprimtarisë tregëtare kjo shoqëri e ka në fushën e “Tregtimin e mallarave të ndryshem industriale, medicinal dhe paisjeve mjekesore me shumice dhe pakice, transport, import-eksport si dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera tregtare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.”

Në vitin 2007 I padituri kundërpaditës ka paraqitur kërkesat me nr. *** dhe me datë depozitimi kerkese *** dhe ka rregjistruar markën tregëtare “****” me nr. rregjistrimi *** dhe date rregjistrimi ***, e mbrojtur për klasën 29 me përshkrimin “qumesht dhe nenproduktet e qumeshtit” dhe “****” me nr. rregjistrimi *** me date depozitim kerkese *** dhe date rregjistrimi *** e rregjistruar ne klasën 29 me përshkrimin e mallit “vaj ushqimor,vaj luledielli”.

Në bazë të çertifikatave, Çertifikatë Ripërtëritje Rregjistrimi Marke me nr. rregjistrimi ***, nr. kerkeses *** dhe me date te mbarimit te mbrojtjes *** si dhe Çertifikate Ripërtëritje Rregjistrimi Marke me nr. rregjistrimi ***, nr. kerkeses *** dhe me date te mbarimit te mbrojtjes deri ne fund te vitit 2027, nga ana e palës së paditur kundërpaditëse, eshte ripërtëritje rregjistrimi i pronesisë së markave tregëtare “****” dhe “****” me afat mbrojtje si më sipër.

Pretendimet e palëve:

Paditësi i kundërpaditur shoqëria “****”sh.p.k pretendoi se: Prej vitit 1997, subjekti tregtar “****” sh.p.k është i mirënjohur për tregtimin me shumicë të sheqerit me paketimin ***, produkt ky i cili sot e kësaj dite tregtohet në të gjithë vendin së bashku me produkte e tjera të ambalazuara nga shoqëria si vaj dhe oriz. Në vitin 2007 me krijimin e AKU-së, subjekti tregtar “****” sh.p.k, u çertifikua nga ky institucion për të gjitha produktet e tij të ambalazuara si sheqer, vaj e oriz etj. Në vitin 2014 subjekti tregtar “****” sh.p.k, nëpërmjet kërkesës ***, ka aplikuar pranë DPPI-së ish DPPM-ja për regjistrimin e emrit të saj tregtar si markë tregtare dhe në datë *** jemi pajisur me çertifikatën e regjistrimit për markën “**** 1993” me nr. regjistrimi ***, e mbrojtur për klasat: 29 - Vajra për gatim, perime kryesisht fasule; 30 - Oriz, Sheqer; 39 - Ambalazhim dhe paketim mallrash ushqimore. Në vitin 2016 subjekti tregtar “****” sh.p.k, nëpërmjet kërkesës ***, ka aplikuar pranë DPPM për regjistrimin e emrit të saj tregtar si markë tregtare dhe në datë *** jemi pajisur me çertifikatën e regjistrimit për markën “****” me nr. regjistrimi ***, e mbrojtur për klasat: 29 - Mish; ekstrakte mishi; xhelatinë mishi; yndyrna të ngrënshme; vaj ulliri për ushqim; vaj luledielli për ushqim.; 30 - Çaj; oriz; tul orizi për gatim; sheqer; kripë për gatim; erëza; miell gruri; miell misri; përgatitje nga drithrat; vanilje; erëza; 39 - Ambalazhim dhe paketim

mallrash ushqimore.

Pala paditëse “****” sh.p.k ushtron prej më shumë se *** vjetësh si subjekt i mirënjohur me aktivitetet në tregtimin e produkteve ushqimore me amballazh “****” dhe markat e regjistruara pranë DPPI-së nga i padituri cënojë emërtimin tregtar të shoqërisë “****” sh.p.k duke shkaktuar konfuzion tek konsumatori për shkak të ngjashmërisë ose më saktë të qëniet identike me emërtimin tonë tregtar si dhe në produktet e tregtuara. Kërkimi i parë i palës paditëse është në lidhje me ngjashmërinë e markës tregtare, emërtimit tregtarë. Shkelja e emërtimit tregtarë dhe markës tregtare bazuar në nenet 143, 156 i Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar për shkak se cënon të drejtën e emrit tregtar, përsa kohë pronari i emrit tregtar prodhon apo të siguron përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet. Marka “****” me nr. kërkesë *** dhe nr. Regjistrimi ***, dhe marka “****” me nr. kërkesë dhe nr. regjistrimi në pronësi të “****” sh.p.k objekt shqyrtimi duhet të shfuqizohen pasi kanë ngjashmëri me emrin më të hershëm tregtar të paditësit si më poshtë: 1.Ngjashmëri Vizuale IDENTIKE; 2. Ngjashmëri Fonetike IDENTIKE, 3.Ngjashmëri Konceptuale sërish IDENTIKE. Në kushtet kur jemi konceptualisht përpara dy emërtimeve që përcjellin informacion identik tek publiku është e paevitueshme që të shkatohet konfuzion tek konsumatori i cili e ka të pamundur të dallojë mallin për nga origjina e tij tregtare. Ky konflikt lind si pasojë e regjistrimit të mëvonshëm të markave “****” dhe “****” identike me emrin tregtar më të hershëm “****”, prandaj në kushtet e mësipërme dhe bazuar në nenet 173, 142 pika 1 gërma a dh 143 pika 3 gërma a, të ligjit nr.9947 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, marka “****” me nr. kërkesë *** dhe nr. Regjistrimi *** duhet të shfuqizohet pasi është identike .Klasa Mallrave dhe Shërbimeve të ofruara janë IDENTIKE klasa 29 vs klasa 29 dhe mundësia e konfuzionit tek konsumatori në këto kushte është jo vetëm e paevitueshme por është pikërisht konsumatori që na bëri me dije në lidhje me ekzistencën e subjektit ***.Markat tregtare “****” dhe “****” objekt shqyrtimi, janë identike nga pikpamja e ngjashmërisë fonetike, vizuale, konceptual dhe në lidhje me klasën e mallrave dhe shërbimeve që kjo markë mbulon dhe shoqëria “****” ofron në treg prej më shumë se *** vjetësh. Rrëshimisht që shkatohet konfuzioni tek konsumatori është i pamohueshëm dhe i paevitueshëm, si pasojë e lidhjes të mallit identik me emërtimin identik të vendosur në këtë mall. Në përputhje me ligjin nr.9947 “Për Pronësinë Industriale” të amenduar, neni 141, në rastin e markës “****” dhe “****” jemi në kushtet e mungesës së karakterit dallues pasi konsumatori nuk do të ishte në gjendje të dallonte mallrat e ofruara në treg nën këtë markë nga ato të ofruar në treg nga shoqëria “****” duke shkaktuar konfuzion në përcaktimin e origjinës tregtare të mallit. Duke ju referuar ligjit nr.9947 “Për Pronësinë Industriale” Neni 142 “Refuzimi ose shfuqizimi për shkaqe absolute” markat “****” dhe “****” përfshihen në parashikimin e pikës 1, gërma a, si marka pa karakter dallues prandaj ato duhen shfuqizuar si të tilla.

Pala e paditur kundërpaditëse pretendoi se:

Nga pala paditëse e kundërpaditur është pranuar në heshtje, përdorimi i markave tregtare “****” të regjistruara nga shoqëria ***. Nga provat e administruara në dosjen gjyqësore markat tregtare më të hershme janë markat tregtare të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithëshme të Pronësisë Industriale markat tregtare “**** ****” dhe “**** ****” në pronësi të shoqërisë *** Tiranë. Në baze të çertifikatës së regjistrimit të markës nr. *** datë ***

“*** **” si dhe të çertifikatës së rregjistrimit të markës nr. *** datë *** “***” të lëshuar nga DPPI Tiranë, rezulton që këto marka janë rregjistruar në regjistrin e markave të Drejtorisë së Patentave dhe Markave si marka të shoqërisë *** shpk. Pra këto marka kanë qenë në përdorim që nga viti 2007 dhe vazhdojnë të jenë deri në vitin 2027 sipas rirregjistrimeve të mëvonëshme. Nga pala paditese e kunderpaditur ne piken 1 te objektit te padise si dhe ne seancat gjyqesore te zhvilluara eshte ngritur edhe pretendimi i cenimit te emrit tregetar te kesaj shoqerie nga perdorimi i markave te rregjistruara, dhe kjo kerkese lidhet me percaktimin ne nenin 143/3/a te ligjit 9947/2008. Siç eshte provuar me provat e administruara dhe siç kemi theksuar me lart, markat tregetare *** jane marka tregetare te rregjistruara qe ne vitin 2008, ne pronesi te shoqerise *** dhe te ripërterira me nje mbrojtje te ketyre markave deri ne fund te vitit 2027. Ndersa shoqeria *** shpk ***, qe pretendon se i eshte cenuar emri tregetar, pasi kjo shoqeri eshte themeluar qe ne vitin 1995, nga perdorimi i markave tregetare ***, eshte e vonuar ne kete pretendim, pasi ka kaluar afati 5 vjeçar i kundërshtimit te nje marke tregetare, dhe pas kalimit te ketij afati nenkuptohet pranimi ne heshtje i kesaj marke tregetare. Kur pronari i një marke të mëparshme, në përputhje me përcaktimin e pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji, pranon në heshtje, për një periudhë të pandërprerë pesëvjeçare, përdorimin e një marke të rregjistruar më vonë në Republikën e Shqipërisë, ai nuk ka më të drejtë, sipas së drejtës që rrjedh nga regjistrimi i markës së mëparshme, të kërkojë deklarimin e pavlefshëm të markës së mëvonshme ose të kundërshtojë përdorimin e markës së mëvonshme për mallrat ose shërbimet, për të cilat marka e mëvonshme është përdorur, përveç kur regjistrimi i markës së mëvonshme është aplikuar në keqbesim. Pra edhe sikur të pranohet se markat e rregjistruara nga shoqeria *** kane cënuar emrin tregëtar të shoqërisë “***” Durrës, theksojme se ligjërisht e drejta e saj e “cënuar” është parashkruar po ti referohemi nenit 160 të ligjit 9947 date 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”. U provua se rregjistrimi i markes *** nga shoqeria *** shpk, eshte marke me e hereshme e rregjistruar se marka *** e shoqerise paditese/e kunderpaditur. Ne piken 2 te objektit te padise se pales paditese/e kunderpaditur, shoqeria *** eshte kerkuar shfuqizimi i markave tregetare te rregjistruara ne pronesi te shoqerise ***, si marka tregetare qe cenojne markat tregetare te rregjistruara nga shoqeria ***. Kjo kerkese ne objektin padise se pales paditese e kunderpaditur, nuk ka asnje baze ligjore ku te mbeshtetet. Referuar nenit 143/1/a, te ligjit 9947 date 07.07.2008, marka tregëtare “*** 1993” me nr. rregjistrimi 16012 datë 09.06.2015 e mbrojtur per klasat 29, 30, 39, dhe marka tregëtare “***” me nr. rregjistrimi 17831 datë 15.05.2017 për klasat 29, 30, 39, rregjistruar në pronësi të shoqërisë ***, duhen të shpallen te pavlefshme nga gjykata pasi kjo markë është e njëjtë në të gjitha drejtimet duke përfshirë edhe logon me markën *** të rregjistruar më parë nga ana e shoqërisë *** shpk qe ne vitin 2007 sic dhe kemi shpjeguar me siper, pra 10 vjet me përpara , periudhë kohore e cila përfshin edhe të drejtën e kundërshtimit të një marke të publikuar që në datën *** nga DPPI. Nga pala paditese/e kunderpaditur nuk ka asnje ankim te depozituar prane pales se trete, per kundërshtimin e markes se publikuar *** ne pronesi te shoqerise *** shpk, ne perputhje me kerkesat e ligjit 9947/2008 neni 152.Pra meqenese marka tregetare ***, ne pronesi te shoqerise *** shpk ka datë rregjistrimi më të herëshme se marka tregëtare “***” e shoqërisë ***,pasi është rregjistruar 10 vjet më përpara ne DPPI, kerkesa e shoqerise *** ne objektin e padise, eshte e pabazuar ne prova e ne ligj.

Në përfundim të analizës së faktit dhe të ligjit, pretendimeve dhe prapësimeve të parashtruara nga palët në këtë gjykim, gjykata do të mbajë në konsideratë nenin 16 të Kodit të Proçedurës Civile, I cili parashikon se gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të bëjnë palët.

Përsa i përket padisë gjykata çmon se:

Gjykata çmon se paditësi legjitimohet në ngritjen e padisë. Kështu duke iu referuar nenit 143 dhe nenit 173 të ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale” nëpërmjet të cilave përcaktohet se çdo person mund të kërkojë shfuqizimin e nje marke të regjistruar në dhomën për shfuqizim/vlerësim. Në çdo fazë të proçedurës pranë DPPI, personi që ka kërkuar shfuqizimin e një marke, ka të drejtë t’i drejtohet drejtëpërdrejtë gjykatës. Siç rezultoi gjatë shqyrtimit gjyqësor paditësi fillimisht i është drejtuar dhomës për shfuqizim/vlerësim dhe më pas gjatë zhvillimit të kësaj proçedure përpara DPPI, i është drejtuar gjykatës.

Lidhur me themelin me padisë gjykata çmon se se padia e ngritur nga paditësi, në kuptim të nenit 160 të ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale”, është parashkruar. Kështu sipas kësaj dispozite kur pronari i një marke të mëparshme pranon në heshtje, për një periudhë të pandërprerë pesëvjeçare, përdorimin e një marke të rregjistruar më vonë në Republikën e Shqipërisë, ai nuk ka më të drejtë, sipas së drejtës që rrjedh nga rregjistrimi i markës së mëparshme, të kërkojë deklarimin e pavlefshëm të markës së mëvonshme ose ta kundërshtojë përdorimin e markës së mëvonshme për mallrat ose shërbimet, për të cilat marka e mëvonshme është përdorur, përveç kur rregjistrimi i markës së mëvonshme është aplikuar në keqbesim. Pavarësisht se dispozita bën fjalë për markat tregtare, duke bërë një interpretim teologjik në tërësi të ligjit, kjo e fundit duhet të zbatohet edhe për shoqëritë tregtare të cilat janë mbajtëse të një emri tregtar. Qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet dispozitave që parashikojnë parashkrimin e padisë synon që të sigurojë zbatimin dhe respektimin e parimit të sigurisë juridike. Nëpërmjet këtij parimi nuk mund të cënohen të drejtat dhe detyrimet e fituara dhe të marra përsipër nga subjektet e së drejtës, të cilët do të ndodheshin në kushte pasigurie nëse do të viheshin në dyshim pas kalimit të një kohe relativisht të gjatë.

Duke iu referuar nenit 144 të ligjit, e drejta eskuzive për markë fitohet nëpërmjet rregjistrimit të tyre në DPPM. Sipas nenit 151 të ligjit, DPPI-ja publikon të dhënat e çdo aplikimi e cila përmbush kushtet e parashikuar për t’u regjistruar si markë. Qëllimi i publikimit është njoftimi i personave të interesuar (ndër to edhe të shoqërive tregtare), të cilat mund të kenë observime apo edhe kundërshtime në lidhje me rregjistrimin e nje marke. Sipas nenit 152, kundërshtimi i një marke të publikuar depozitohet brenda nje periudhe tre mujore pranë DPPI. Sipas nenit 156, pronari i markës së rregjistruar gëzon të drejtën eskuzive të përdorimit të saj, si dhe të drejtën të ndalojë personat e tretë në përdorimin e saj, pa autorizimin e tij. Pra ligjvënësi i ka dhënë rëndësi si publikimit ashtu edhe rregjistrimit të markave tregtare duke synuar, nga njëra anë mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave të tretë të cilët mund të cënohen nga rregjistrimi i një marke tregtare, dhe nga ana tjetër duke e kufizuar këtë të drejtë brenda afateve të caktuara kohore, të cilat maksimalisht (në rast se marka është regjistruar) mund të shkojnë deri në pesë vjet sipas nenit 160.

Rezulton se i padituri kundërpaditës ka depozituar kërkesë në datë *** për të rregjistruar markën “*** ***” e cila është rrëgjistruar në datë *** me nr. rregjistrimi *** dhe me datë

depozitimi regjistruar në klasën 29 me përshkrimin “qumësht dhe nënproduktet e qumështit”. Gjithashtu edhe marka “**** ****” është regjistruar në të njëjtën datë, *** me nr. regjistrimi *** date sipas kërkesës së depozituar në datë *** e regjistruar ne klasën 29 me përshkrimin e mallit “ vaj ushqimor, vaj luledielli”. Rezulton se rregjistrimi është ripërtëritë në bazë të çertifikatave, Çertifikate Ripërteritje Regjistrimi Marke me nr. regjistrimi *** , nr. kerkeses *** dhe me date te mbarimit te mbrojtjes *** si dhe Çertifikate Ripërteritje Regjistrimi Marke me nr. rregjistrimi *** , nr. kerkeses *** dhe me date te mbarimit te mbrojtjes deri ne fund te vitit *** , për markat tregtare “**** ****” dhe “**** ****” me afat mbrojtje si më sipër. Nga ana e paditësit të kundërpaditur nuk u kundërshtua për asnjë moment parashkrimi i padisë i ngritur si prapësim nga i padituri kundërpaditës. Pra nga ana e palës paditëse të kundërpaditur rregjistrimi i këtyre markave të përdorura nga i padituri është kundërshtuar tej afatit 5 vjeçar, të parashikuar nga neni 160 i ligjit. Për këtë arsye gjykata çmon se padia e ngritur nga shoqëria “****” sh.p.k duhet të rrëzohet si e parashkruar. Paditësi i kundërpaditur shoqëria “****” sh.p.k kundërshtoi në gjykim faturat tatimore të paraqitura nga i padituri kundërpaditës me nr. 1 datë 14.10.2015 dhe fatura nr. 43 datë 27.04.2012, duke u kërkuar të mos merren si prova në gjykim pasi kanë klasa produktesh që nuk janë pjesë e objektit të gjykimit dhe të shqyrtimit gjyqësor, kërkesë kjo e bërë dhe më shkrim. Konkretisht në to pasqyrohej produkti i cilësuar si kërpudhe ***.

Në fakt pretendimet e padisë dhe orientimi i gjykimit ishte te klasat 29 e produkteve për të cilin pala paditëse paraqiti dhe prova për produktet vaj ushqimor, vaj luledielli, qumësht dhe nënprodukte qumshiti produkte të mbrojtura nga markat e rregjistruara nga i padituri. Gjykata vëren gjithashtu se paditësi ka bërë saktësim të objektit të padisë me pikën e 3 të tij duke kërkuar: Ndalimin e konkurrencës së pandershme nga i padituri. Kjo kërkesë për saktësim është kryer në datë 07.02.2018 ende pa u paraqitur provat e të paditurit pra pa u paraqitur këto fatura, ç’ka provon se kjo pikë e objektit të padisë ka qenë e lidhur qenësisht me dy pikat e para të objektit të padisë pra shfuqizimin e markave të të paditurit qe mbronin produktet e klasës 29 vaj ushqimor, vaj luledielli, qumësht dhe nënprodukte qumshiti ashtu sikundër pretendoi dhe paditësi kundërpaditur.

Gjykata vëren se paditësi gjatë gjykimit nuk pretendoi dhe as paraqiti ndonjë prove që i padituri ti kryente konkurrencë nëpërmjet produkteve të tjera përveç atyre të klasës 29 të rregjistruara në markën e të paditurit dhe për këtë arsye ai dhe kërkoi që këto fatura të mos merreshin si prova në gjykim. Gjykata në fakt në këtë vendim nuk i çmon këto prova si pjesë të shqyrtimit gjyqësor . Pasqyrimi në faturë tatimore i një produkti si kërpudhë *** (dhe kjo vetem në dy fatura ndërkohë që në gjithë faturat e tjera është shënuar vetëm kërpudhë) nuk përbën pjesë të shqyrtimit të këtij gjykimi për konkurrencë të pandershme pasi ky gjykim kishte për objekt markat e rregjistruar nga i padituri kundërpaditës për klasat 29 te mallrave.

Përsa i përket kundërpadisë gjykata çmon se:

I padituri kundërpaditës në kundërpadi, me anë të kundërpadisë objekt shqyrtimi, pretendon cënimin e së drejtës të markave tregtare “**** ****” dhe “**** ****” nga ana e palës paditëse së kundërpaditur. Sipas pretendimeve të kundërpaditësit, i kundërpadituri nëpërmjet përdorimit të markave tregtare “****” dhe “****” ka krijuar konfuzion tek konsumatori duke mos i bërë më të dallueshme produktet e tij nga ato të të kundërpaditurit. Sipas kundërpaditësit markat

në pronësi të tij kanë datë regjistrimi më të hershme se ato të kundërpaditurit konkretisht në vitin 2008 me kërkesë të depozituar në 2007 dhe për rrjedhojë këto të fundit duhen shfuqizuar.

Nga ana tjetër i kundërpadituri ka prapësuar se marka tregtare, shoqëria “****” sh.p.k është themeluar në vitin 1995, pra në një kohë më të hershme se kundërpaditësi. Për pasojë kundërpadia duhet rrëzuar si pambështetur në prova dhe në ligj.

Gjykata çmon se i padituri kundërpaditës legjitimohet në ngritjen e kundërpadisë. Sipas nenit 173 të ligjit 9947 datë 7.07.2008 “Për pronësinë industriale” kërkesa për shfuqizimin e nje marke të regjistruar bëhet nga çdo person pranë dhomës për shfuqizim/vlerësim, me përjashtim të rastit kur është duke u zhvilluar një gjykim në lidhje me të njëjtën markë. Në këtë rast kërkesa duhet bërë gjatë këtij gjykimi. Siç rezulton midis palëve ndërgjyqëse është duke u zhvilluar gjykim sipas objektit të padisë, për pasojë, kundërpaditësi, legjitimohet në kundërshtimin e regjistrimit të markave tregtare “****” dhe “****”.

Lidhur me themelin e kundërpadisë gjykata çmon se në bazë të neneve 140 dhe 141 të ligjit 9947 datë 7.07.2008 “Për pronësinë industriale”, markë mund të konsiderohet çdo shenjë, në veçanti fjalët. Marka për t’u konsideruar e tillë, duhet të plotësojë në mënyrë kumulative këto kushte: (i) të jetë shenjë ose fjalë; (ii) të ketë karakter dallues, pra të jetë e aftë që të bëjë të mundur dallimin e mallrave apo shërbimeve të një subjekti tregtar nga një subjekt tjetër tregtar; (iii) të jetë e përfaqësuar në regjistër. Siç ka rezultuar qartë gjatë shqyrtimit gjyqësorë, markat në pronësi të kundërpaditësit i plotësojnë në mënyrë kumulative këto kushte (fakt i cili nuk është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse.)

Sipas nenit 143/2/a marka nuk regjistrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme. Gjithashtu marka nuk mund të regjistrohet dhe nëse është regjistruar duhet të deklarohet e pavlefshme nëse është e njëjtë me një markë të mëparshme, si dhe mallrat dhe shërbimet për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme.

Siç ka rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor markat në pronësi të të paditurit kundërpaditës janë rregjistruar më parë në kohë se ato të paditësit të kundërpaditur. Dhe më konkretisht marka tregtare “**** ****” është regjistruar në datë ***, me nr. regjistrimi *** dhe me datë depozitimi kerkese ***. Ndërsa marka “**** ****”, është regjistruar po në të njëjtën datë *** me nr. regjistrimi *** date depozitim kerkese ***. Ndërkohë paditësi i kundërpaditur në datë *** është pajisur me çertifikatën e regjistrimit për markën “****” me kërkesë të depozituar në *** me nr. regjistrimi *** dhe në datë *** është pajisur me çertifikatën e regjistrimit për markën “****” me nr. regjistrimi *** me kërkesë të depozituar ***. Pra pala e paditur kundërpaditëse është brenda afatit 5 vjeçar të kundërshtimit me padi në gjykatë të markës të rregjistruar nga paditësi i kundërpaditur, pavarësisht se emri tregëtar i paditësit është i hershëm që prej vitit 1995. Gjykata arrin në këtë përfundim pasi i padituri kundërpaditës po kundërshton regjistrimin e markës dhe jo konkurrencën e pandërshme për shkak të përdorimit të emrit tregëtar nga paditësi.

Përsa i përket prapësimit të të kundërpaditurit se marka tregtare shoqëria “****” është regjistruar më parë, gjykata vlerëson se një prapësim i tillë nuk është i mbështetur në ligj. Në rasti konkret objekt gjykimi i kundërpadisë është rregjistrimi i markës nga paditësi i kundërpaditur dhe jo përdorimi i emrit tregëtar dhe ky rregjistrim i nënshtrohet një procedurë të posaçme rregjistrimi me ligj të veçantë dhe nga një organ përkatës siç është DPPI. Emri

tregtar dhe marka tregtare kanë ndryshime thelbësore ndaj njëra-tjetrës. Kështu emri tregtar përfaqëson emrin e një shoqërie dhe si rregull përfaqëson identifikimin e shoqërisë sipas llojit të aktivitetit që shoqëria ushtron si p.sh për efekt të legjislacionit tatimor etj, ndërsa marka tregtare përfaqëson produktet apo edhe shërbimet që nxirren në qarkullimin civil nga subjektet e së drejtës. Pra marka tregtare ka për synim mbrojtjen e një produkti apo shërbimi të caktuar, ndërsa emri tregtar identifikon një subjekt të së drejtës civile, siç janë personat juridik, nga subjektet e tjera.

Përsa i përket ngjashmërisë së markave objekt shqyrtimi i kundërpadisë, gjykata çmon se ato janë identike dhe krijojnë konfuzion tek konsumatori në lidhje me përkatësinë e mallrave të nxjerra nga palët në qarkullimin civil dhe ky fakt pranohet dhe nga vetë paditësi në padi. Kështu nga pikëpamja vizuale markat kanë ngjashmëri. Emërtimi i markës “*** **” dhe “*** **” përbëhen nga 2 fjalë “***” dhe “***” si dhe “***” dhe “***”. Fjalet *** dhe ** janë të përjashtuara nga mbrojtja. Marka tregtare në pronësi të kundërpaditësit “***” përbëhet nga dy fjalë: “***” e cila gëzon mbrojtje dhe “” e cila nuk gëzon mbrojtje. Ndërsa marka tregtare “***” përbëhet nga një fjalë e cila gëzon mbrojtje.

Duke ju referuar analizës së mësipërme jemi përpara rastit të markave identike me një emërtim tregtar nga pikëpamja vizuale pasi fjalët “***” vs “***” janë identike, të përbëra nga 5 karaktere të njëjta secila dhe me renditje të njëjtë.

Nga pikëpamja fonetike marka objekt shqyrtimi gjyqësor janë identike me njëra tjetrën sa kohë në gjuhën shqipe, fjalët ashtu si shkruhen ashtu edhe lexohen. Duke analizuar elementët e mësipërm fonetik shqiptimi i tyre është identik. Përsa i përket krahasimit të mallrave, palët ndërgjyqëse ofrojnë të njëjtat mallra për konsumatorin por gama e mallrave të mbrojtura nga paditësi i kundërpaditur shoqëria *** sh.p.k është me e gjerë. Kështu pala e paditur kundërpaditëse i ka regjistruar mallrat e saj në klasën 29, vaj ushqimor, vaj luledielli, qumësht dhe nënprodukte të qumshtit. Po ashtu edhe pala paditëse e kundërpaditur, ndër të tjera, i ka regjistruar mallrat e saj në klasën 29 por me një game shumë më të gjerë. Për rrjedhojë cënimi i markave të regjistruara nga i padituri kundërpaditës qëndron vetëm tek produktet që i padituri kundërpaditës Shoqëria *** sh.p.k ka të mbrojtur dhe konkretisht vaj ushqimor, vaj luledielli, qumësht dhe nënprodukte të qumshtit.

Neni 143-Refuzimi ose shfuqizimi për shkaqe relative parashikon se: “ 1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme. 2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur: a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;”

Për sa u përket më sipër, plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 143/2/a: (i) markat tregtare në pronësi të paditësit së kundërpaditur janë identike me markat tregtare në pronësi të paditurit kundërpaditës;(ii) i padituri kundërpaditës gëzon një të drejtë mbrojtje të mëparshme se paditësi i kundërpaditur;(iii) mallrat e nxjerra në qarkullimin civil nga palët ndërgjyqëse janë identike.

Sakaq gjykata arrin në konkluzionin se kundërpadia e paraqitur nga i padituri duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126 dhe 306-310 të Kodit të Proçedurës Civile;

VENDOSI

1.Rrëzimin e padisë së paditësit të kundërpaditur “****” shpk, përse i përket shfuqizimit të markës “****” me nr.regj. ***, datë regj. *** për klasën e mallrave 29 qumësht dhe nënprodukte të qumështit dhe markës *** ** me nr.regj. ***, datë regj. ***për klasen e mallrave 29 vaj ushqimor, vaj luledielli.

2.Pranimin e kundërpadisë së të paditurit kundërpaditës Shoqëria “****”shpk duke shfuqizuar markën tregëtare “****” shpk me nr.regjistri ***, datë regj. *** për klasën e produkteve të mbrojtura nr.29, vetëm për produktin vajra për gatim dhe markës tregëtare “****”, me nr.regj. *** datë regj. *** vetëm për klasën e mallrave vaj ushqimor, vaj luledielli për ushqim.

3.Ndalimin e përdorimit të markes “****”, për produktet e sipërcituara prej palës paditëse të kundërpaditur “****”shpk dhe pushimin e cënimit për këto produkte në të ardhmen.

4.Publikimin e vendimit përfundimtar në Buletinin e radhës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

5.Shpënzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse të kundërpaditur.

6.Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi. Për palën e papranishme ky afat fillon nga e nesërmja e marrjes dijeni.

U shpall në Tiranë sot më datë 01.10.2018

Sekretare
Anjeza Nergjoni

Gjyqtare
Eneida Civici